



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:181637

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05652527

C.nr.1819/20

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.Gj. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës “BKS” me seli në Prishtinë, e përfaqësuar sipas autorizimit nga Kompania e Sigurimeve “P.....” Sh.a. me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, me vlerë të kontestit 3,000.00 (tre mijë) euro, pas mbajtjes së seancës përgaditore, me datë 03.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M **NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA**

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit A.Gj. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të “APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësit A.Gj. në tërësi si e bazuar “OBLIGOHET e paditura “BKS” me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit jo material si pasojë e shëmtimit t’i paguaj paditësit shumën prej 3,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim si dhe të OBLIGOHET e paditura, që t’i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore” **SI E PA BAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësi A.Gj. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. D.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datën 21.12.2020, ka parashtruar padi, kundër të paditurës “BKS” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, me vlerë të kontestit 3,000.00 (tre mijë) euro.

Në referatin e padisë ka theksuar se me datën 03.08.2017 në Rr. “Besim Shala” në Prizren, ka ndodhur fatkeqësi komunikacioni me lëndime trupore për të dëmtuarin, ku deri te ky aksident ka ardhur nga pasiguria e vozitësit A.Sh.L. i cili duke lëvizur me motoçikletë në mënyrë të rrezikshme hynë në tejkalim dhe e godet automjetin B, më gjerësisht si në raportin policor. Në vazhdim ka theksuar se automjeti A si shkaktar i aksidentit në momentin e

shkaktimit të aksidentit nuk ka pasur të regjistruar dhe të siguruar motoçikletën. Si rezultat i këtij aksidenti komunikacioni ushtruesi i padisë, ka pësuar lëndime trupore të përcjellura me dhimbje fizike, frikë, shëmtim trupor, pastaj ka qenë i nevojshëm ushqimi i përforcuar dhe i njëjti ka bërë shpenzime materiale. Ka theksuar se lidhur me kategorinë e dëmeve materiale dhe jo materiale është vendosur me aktgjykimin e kësaj gjykate me numër C.nr.1474/2018, të datës 17.12.2019, me përjashtim të shëmtimit. Në fund ka theksuar se baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuese pasi që aksidenti i komunikacionit është shkaktuar sipas policisë me lëshimet e drejtuesit të automjetit A. E paditura ka pranuar kërkesën për kompensimin e dëmit material dhe jo material në procedurë administrative, por që e njëjta ka theksuar se kërkesa e palës së dëmtuar është paraqitur pas afatit ligjor, andaj mbi bazën e lartcekurave i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e bazuar.

Me datën 30.04.2024, gjykata ka mbajtur seancën përgaditore në këtë çështje kontestimore, dhe në këtë seancë i autorizuari i paditësit av. D.M. nga Prizreni ka deklaruar se duke u gjendur në një situatë të tillë dhe referuar provave të cilat i posedojnë, po ashtu faktit se për pjesën më të madhe të të drejtës për kompensim paditësi veç se është kompensuar, ku ka ndodhur gabim teknik në lidhje me kërkesën në lidhje me kompensimin në emër të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e shëmtimit, por duke marrë për bazë se nuk është më ndonjë relevancë e madhe, mbi këtë bazë e njofton gjykatën se e tërheq padinë gjegjësisht kërkesëpadinë duke i propozuar gjykatës që të bie aktgjykim për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadia.

I autorizuari i të paditurës D.I. në seancën përgaditore ka deklaruar se nuk i kundërshtojnë theksimet e palës paditëse për të hequr dorë nga kërkesëpadia, konsiderojnë që janë plotësuar kushtet ligjore që gjykata të bie aktgjykim për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadia.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 3 par. 2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) ku përcaktohet se *“Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë ujdi (pajtim) gjyqësorë lidhur me kontestin e tyre”*, si dhe sipas nenit 149, par. 1 të LPK-së me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”*, poashtu sipas nenit 149 par. 1 LPK parashihet se *“Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”*, andaj pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 3 par.3.2 dhe neni 149 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1819/20, me datë 03.05.2024

B.profesional
Ali Kosova

Gjyqtari
Agron Karatash

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.